



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Legjislatura e III-të

Nr. 26/09

Prishtinë, më 4.11.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha dhe Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët e jo të pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Enis Kervan, Hetem Arifi dhe Zafir Berisha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Kryesuese: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetare parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendite te ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 15.10.2009;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

Numan Balić, propozoi që në kuadër të rendit të ditës të shqyrtohet edhe çështja që ka të bëjë shkeljen e dispozitave të Ligjit të Shtetësisë, përkatësisht dokumentacionet apo kushtet që kërkohen për marrjen e shtetësisë.

Zylfi Merxha, u pajtua me propozimin e z. Balic.

Sadik Idriz, theksoi se për problemet me zbatimin e Ligjit të Shtetësisë është diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe është nxjerr përfundimi që të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në mbledhjen e komisionit për të dhënë sqarime për situatën e krijuar. Nëse diskutojmë pa prezencën tij, asgjë nuk mund të bëjmë në këtë drejtim.

Müfera Şinik, theksoi se pajtohet me propozimin e z. Idriz, që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri, dhe pastaj të dalim me rekomandime si Komision për këto çështje.

Xhevdet Neziraj, duke u ndërlidhur me diskutimet, theksoi se do të ishte më produktive që në fillim të diskutojmë në praninë e zyrtarëve nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të marrim përgjigjet e tyre lidhur me këtë çështje, pastaj sipas nevojë të dalim me rekomandime si komision.

Kosara Nikolić, propozoi që për këtë çështje të diskutohet në prezencën e Ministrit, ndërsa në këtë mbledhje të merret qëndrimi që ministri të ftohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

Numan Balić, kërkoi që kjo çështje të futet për diskutim si pikë e veçantë e rendit të ditës. Më pas me shkresë të njoftohet Ministri se është shkelur ligji për shtetësinë dhe të ftohet në mbledhjen e komisionit për të dhënë sqarime për këtë çështje.

Kryesuesja, nga diskutimet shifet se kemi dy propozime. Propozimi parë është kërkesa e z. Balic, që të futet si pikë plotësuese e rendit të ditës çështja e zbatimit të Ligjit për Shtetësinë. Propozimi i dytë që për këtë çështje paraprakisht të ftohet ministri, pastaj të diskutohet në komision. Theksoi se për këtë çështje mund të diskutohet në të ndryshme, si dhe njëkohësisht të ftohet ministri për mbledhjen e radhës së komisionit për të dhënë sqarimet e kërkuara lidhur me zbatimin e Ligjit të Shtetësisë. Gjithashtu njoftoi se në të ndryshme do të diskutohet edhe për dy çështje. E para për vizitën e planifikuar në Zvicër. Ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me një peticion që është drejtuar komisionit nga një grup qytetarësh të komunës së Pejës.

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 15.10.2009

Kryesuesja, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt.15.10.2009, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente

Kryesuesja, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Numan Balić, theksoi se edhe në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi kërkuar që ai të plotësohet me dispozitat ku parashihen ndarja e dekoratave dhe medaljeve edhe për komunitet joshumicë. Andaj do të duhej që paraprakisht të konsultoheshin komunitetet, dhe më pas përfaqësuesit e tyre të dalin me propozime konkrete. Deri atëherë kërkoi që miratimi i këtij projektligji të shtyhet.

Sadik Idriz, theksoi se nuk jemi të gatshëm që sot të japim propozimet. Prandaj projektligji të shtyhet në mbledhjen tjetër të komisionit, në mënyrë që të krijohet mundësia e konsultimit të komuniteteve dhe të dilet me propozime konkrete për plotësimin e projektligjit në çështjet e ndarjes së dekoratave për komunitetet tjera.

Zylfi Merxha, gjithashtu propozoi që miratimi i projektligjit të shtyhet për në mbledhjen e radhës, deri sa të konsultohemi me komunitetet dhe të dalim me propozime konkrete.

Kryesuesja, pasi që kemi shumë propozime që miratimi i projektligjit të shtyhet për mbledhjen tjetër të komisionit, kërkoi që përfaqësuesit e komuniteteve të konsultohen me komunitetet që përfaqësojnë dhe të sjellin propozim amendamentet konkrete, të cilat do të shqyrtohen dhe votohen në komision.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I.** Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente, shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit.
- II.** Përfaqësuesit e komuniteteve (anëtarë të komisionit) të konsultojnë komunitetet që përfaqësojnë dhe në një afat të shkurtër kohorë të dalin me propozim-amendamente konkrete, për plotësimin e këtij projektligji, në ndarjen e dekoratave nga Presidenti për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente

Kryesuesja, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin kundër korrupsionit, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Të ndryshme

5.1. Diskutim për zbatimin e Ligjit të Shtetësisë në Kosovë

Numan Balić, theksoi nga biseda që ka pasur me qytetarët e komunës së Pejës dhe Istogut, të interesuar për marrjen e shtetësisë kosovare, ka vërejtur se po u kërkohen shumë dokumentacione duke i trajtuar si persona të huaj, edhe pse personat në fjalë kanë letërnjoftime të UNMIK-ut, si dhe vendqëndrim të përhershëm më tepër se pesë vite në Kosovë. Në këtë mënyrë po shkelet neni 28 dhe 29 i ligjit për shtetësinë. Për këtë çështje kam biseduar edhe me kryetarin e komunës së Pejës, i cili është pajtuar se është shkelur ligji. Prandaj propozoi që më një shkresë të njoftohet ministri për shkeljen e ligjit dhe të ftohet që në mbledhjen e komisionit të jap sqarime për moszbatimin e ligjit.

Kosara Nikolić, njoftoi se për shkak të këtyre problemeve me dokumentacionin në marreje shtetësisë, ka ndikuar që një numër i madhë i qytetarëve serb që kanë mbushur 18 vjet apo kanë aplikuar për shtetësi, të mos mund të votojnë në zgjedhjet lokale.

Kryesuesja, propozoi që për të sqaruar këto çështje, me një shkresë të njoftohet ministrit i punëve të brendshme për problemet në zbatimin e ligjit të shtetësisë dhe të ftohet në mbledhjen e radhës për të dhënë sqarime për këto çështje.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Ftohet Ministri i Punëve të Brendshme në mbledhjen e radhës së komisionit për të dhënë sqarime për moszbatimin e ligjit për shtetësinë në Kosovë, përkatësisht për shkeljen e nenit 28 dhe 29 të këtij ligji.

5.2. Informata për vizitën studimore në Zvicër

Kryesuesja, njoftoi anëtarët se vizita e planifikuar për në Zvicër, është prolonguar për javën e tretë të muajit janar 2010. Për të përgatitur agjendën e kësaj vizite, kam bërë disa propozime në emër të komisionit se qfarë takimi priten të realizohen dhe cilat institucione të vizitohen.

Elita Vokshi (OSCE), njoftoi se buxheti i OSCE i paraparë për këtë vizitë nuk mund të transferohet tjetrin vit sepse të tilla janë rregullat buxhetore.

5.3. Informata për petitionin drejtuar Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Kryesuesja, njoftoi për petitionin e dërguar nga një grup qytetarësh të fshati Vitomiricë të komunës së Pejës, i cili është adresuar gabimisht komisionit tonë. Kompetentë për të shqyrtuar petitionet është Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, për çka edhe do të adresohet te ai komision.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ